

Hapet thirrja për bursa mobiliteti për stafin e Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin Tuscia, Itali.

Në kuadër të programit Erasmus +, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin e Universitetit të Tiranës në Universitetin Tuscia në Itali për vitin akademik 2018-2019.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie/trajnim;
- Shkëmbimin e stafit ndihmës akademik me karakter administrativ për trajnim;
- Shkëmbimin e stafit administrativ për trajnim;

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 ditë (plus 2 ditë udhëtim);

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për mësimdhënie:

- CV(në gjuhën angleze) + Lista e publikimeve;
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Certifikata e gjuhës së huaj;
- Vërtetim punësimi në Gjuhën Shqipe;
- Vetëdeklarim nëse stafi ka kryer më parë mobilitet Erasmus+;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

Dokumentat e nevojshme për aplikim për trajnim:

- CV(në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikata e gjuhës së huaj;
- Vërtetim punësimi në Gjuhën Shqipe;
- Vetëdeklarim nëse stafi ka kryer më parë mobilitet Erasmus+;
- Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për trajnim klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf

**Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Afati për aplikim: **2 Nëntor 2018**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentat dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe të dërgohen njëkohësisht të skanuara në adresën iro@unitir.edu.al

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!